



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 145/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Konstatohet e tërhequr ankesa Anr. 145/2013 e datës 03.10.2013 e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës Anr. 145, me datë 05.10.2013, të PDK-së me të cilën pala ankuese kërkon tërheqjen e ankesës të parashtruar në PZAP me datë 03.10.2013, kundër subjektin politik AAK, dega Ferizaj, me arsyetimin se kanë hasur në disa persona të cilët kanë vendosur posterat në fjalë, dhe të cilët këta persona nuk kanë qenë të subjektit politik AAK, dega Ferizaj andaj edhe është kërkuar të tërhiqet kjo ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 145/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 145/2013 më datën 05.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi

